Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

Факултет за Исламски Науки –Скопје

Faculty of Islamic Science – Skopje

İslâmî Bilimler Fakültesi – Üsküp

www.fshi.edu.mk

Fillo Studio Hulumto Islamin

FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME - SHKUP

Факултет за Исламски Науки - Скопје

Faculty of Islamic Science - Skopje

İslâmî Bilimler Fakültesi – Üsküp

www.fshi.edu.mk

Fillo Studio Hulumto Islamin

Fjala e dekanit

Të nderuar maturantë,

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup, mision të vetin ka krijimin, përcjelljen, mbrojtjen e dijeve, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve dhe formimit të specialistëve të lartë në fushat e studimeve islame, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Vizioni ynë është të ndërtojmë një fakultet modern, të fokusuar drejt së ardhmes, të vlefshëm për shoqërinë tonë multietnike dhe multifetare, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend, si edhe në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal.

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup është një fakultet me qasje kah studenti, prandaj në cilësinë e dekanit të Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup ju garantoj mbështetjen time të plotë. Të dashur maturantë, në FSHI do të gjeni një ambient të ngrohtë, mikpritës dhe të gjallë studentor, një staf akademik dhe administratë profesionale të përkushtuar, që do t'u vijë në ndihmë në çdo kohë. Por ju do të punoni që dijen ta merrni me sprova e lexime.

Mos lejoni askënd të shuajë pikëpyetjet e juaja! Mos u mërzit nga tekste që mund mos të ju pëlqejnë, as nga provimet të bëra që ndoshta do të duken të mërzitshme! Puno dhe lexo pa paragjykime, s'ka rëndësi në janë mësime ligjëratash, në janë libra apo informacione interneti, s'ka fare rëndësi – vetëm lexo, sepse dija të bën të lirë, të ditur! Një njeri i shkolluar mirë është një njeri i lirë.

Si dekan i Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup kam për qëllim

Krijimin e një ambienti, ku përvetësimi i dijes do të jetë në qendër të vëmendjes;

Pasurimin e bibliotekës së fakultetit me literaturë të re në gjuhët e huaja, e sidomos në gjuhën shqipe, gjë që do të ndihmojë kultivimin e njohurive nga shkencat islame;

Afirmimin e përkushtimit të Fakultetit të Shkencave Islame në lirinë e të menduarit, të shkruarit dhe të folurit.

Angazhimin e stafit kualitativ dhe me përvojë universitare në vend dhe jashtë vendit;

Zhvillimin dhe mirëmbajtjen atraktive, funksionale për përkrahjen e mësimdhënies;

Të krijojë kuadër me pikëpamje të reja dhe mënyra e të menduarit, dhe të mundësojë zhvillimin e aftësive dhe pranimin e sfidave dhe mundësive, të cilat i ofron shekulli 21.

T'i integrojë mësimdhënien, aktivitetet kreative dhe shkëmbimin e ideve;

T'i përgatit studentët të ndërtojnë karrierë në sferën e shkencave islame, që të punësohen në institucionet e BFI-së në RMV;

Integrimin e teknologjive informative në procesin e mësimdhënies

Ju mirëpresim!

Prof. dr. Shaban Sulejmani

Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame – Shkup

Dean's word

Dear Graduates,

The mission of the Faculty of Islamic Sciences-Skopje, is to create, transmit, and protect knowledge through teaching, research, services and training of senior specialists in the fields of Islamic studies in accordance with state development priorities. Our vision is to build a modern, straightforwardly focused faculty of the future, valuable to our multiethnic and multi-religious society, contributing to raising the standards of democracy in the country, as well as in economic, social and cultural development at national and regional level.

The Faculty of Islamic Sciences- Skopje, is a student oriented faculty hereby on behalf of the Dean of the Faculty I guarantee you my overall support. Dear high school graduates, in the FIS you will be provided a warm, hospitable and lively student environment, a dedicated academic staff and professional administration that will be of your service any time. However, you have to work to get your knowledge through readings and challenges.

Do not let anyone erase your question marks! Do not get bored of texts that you may not like, nor of exams taken that will probably look boring! Work and read without prejudice, it does not matter if it is lectures, whether it is books or internet information, it does not matter at all - just read, because knowledge makes you free, knowledgeable! A well educated man is a free man.

As Dean of the Faculty of Islamic Sciences - Skopje I intend in creating an environment where knowledge acquisition will be the center of attention; Enriching the faculty's library with new literature in foreign languages, especially in Albanian, which will help cultivate knowledge from Islamic sciences; Affirmation of the commitment of the Faculty of Islamic Sciences to freedom of thought, writing and speech. Engaging quality and experienced university staff in the country and abroad;

Attractive, functional development and maintenance to support teaching; Create a framework with new perspectives and ways of thinking, and enable the development of skills and acceptance of the challenges and opportunities offered by the 21st century.

Integrate teaching, creative activities and the exchange of ideas; To prepare students to build careers in the field of Islamic sciences, to be employed in IRC institutions in RNM ; Integration of information technologies in the teaching process.

We are looking forward to welcoming you!

Prof. dr. Shaban Sulejmani

Dean of the Faculty of Islamic Sciences - Skopje

Cikli parë

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Shkencat Islame	**8**	**240**	**Profesor i diplomuar në shkencat Islame**

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Kur'ani dhe Texhvidi I	I	6	Kur'ani dhe Texhvidi II	II	6
Shkenca e Kelamit	I	6	Bazat e besimit Islam Usul-al-din	II	6
Fonetika e gjuhës arabe	I	6	Morfologjia e gjuhës arabe	II	6
Historia e së drejtës Islame	I	6	Fikhul-ibadat	II	6
Gjuhë angleze	I	3	Metodologjia hulumtuese shkencore	II	3
Lëndët zgjedhore	**S**	**ECTS**	**Lëndët zgjedhore**	**S**	**ECTS**
Demokracia dhe të drejtat e njeriut	I	3	Religjioni dhe shoqëria	II	3
Gjuhë shqipe	I	3	Gjuhë maqedone	II	3

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Kur'ani dhe Texhvidi III	III	6	Kur'ani dhe Texhvidi IV	IV	6
Shkolla e hershme e Kelamit	III	6	Hyrje në studime të religjioneve	IV	6
Sintaksa e gjuhës arabe	III	6	Konverzacioni i gjuhës arabe	IV	6
Usuli fikhi	III	6	E drejta familjare Islame	IV	6
			Fikhusire	IV	3

Lëndët zgjedhore	S	ECTS	Lëndët zgjedhore	S	ECTS
Shkrim Akademik	III	6	Historia e filozofisë së përgjithshme	IV	3
Informatikë	III	6	Gjuhë turke	IV	3

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Hyrje në shkencën e Tefsirit	V	6	Metoto. e komentuesve të Kur'anit	VI	6
Hyrje në shkencën e Hadithti	V	6	Metodologjia e studiuesve të Hadithit	VI	6
E drejta e vakëfit dhe trashëgimisë	V	6	E drejta civile dhe penale Islame	VI	6
Pedagogji – Psikologji	V	6	Historia e kulturës Islame	VI	6

Lëndët zgjedhore	S	ECTS	Lëndët zgjedhore	S	ECTS
Dialogu ndërfetar në konteks të RMV-së	V	6	Orientalistika dhe orientalizmi	VI	6
Gjuhë osmane	V	6	Didaktika dhe Metodika e mësi.fetar	VI	6

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Tefsir analitik	VII	6	Tefsir tematik	VIII	6
Hadith analitik	VII	6	Hadith tematik	VIII	6
Studimi komperativ i feve	VII	6	Filozofia Isalme	VIII	6
Civilizimi Islam	VII	6	Punimi i diplomës	VIII	6

Lëndët zgjedhore	S	ECTS	Lëndët zgjedhore	S	ECTS
Sociologjia e edukimit	VII	6	Historia e perandorisë Osmane	VIII	6
Etika e Religjionit	VII	6	Retorikë dhe Dave	VIII	6

Cikli dytë | **Studime të magjistraturës**

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Studime të avancuara Islame	2	60	Magjistër në studimet islame

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Interpretimi klasik dhe modern i Kur'anit	I	7	Studimi krahasimtar në studimin e Hadithit	II	5
E drejta Isalme dhe Intenca e Sheriatit	I	7	Studime klasike dhe moderne akideologjike (doktrinore)	II	5
Metodat e hulumtimit shkencor	I	6	Punimi i magjistraturës	II	15
Lëndët zgjedhore	**S**	**ECTS**	**Lëndët zgjedhore**	**S**	**ECTS**
Historia Islame dhe qytetërimi	I,II	5	Islami në shoqërinë moderne	I,II	5
Trende bshkëkohore Islame	I,II	5	Sociologjia e religjionit	I,II	5
Komunikimi i mesazhit islam në periudhën bashkëkohore	I,II	5	Ligji, shteti dhe feja	I,II	5
Problematikat themelore të Filozofisë fetare	I,II	5	Perspektiva e Islamit në Evropë	I,II	5
Udhëheqja fetare në shoqërinë modern	I,II	5	Demokracia dhe të drejtat e njeriut	I,II	5
Islami dhe Gadishulli Ballkanik: Perspektiva dhe Realiteti	I,II	5	Studimet krahasuese të religjioneve	I,II	5
Filozofia Islame klasike dhe modern	I,II	5	Marrëdhënia ndërmjet shkencës dhe fesë	I,II	5
Historia moderne e botës muslimane dhe organizatave islame	I,II	5	Teoria, gjuha, stili dhe përkthimi i Kur'anit	I,II	5
Dialogu ndërfetar	I,II	5			

Cikli dytë | **Studime të specializimit**

Programi studimor	S	ECTS	Kualifikimi
Metodika e mësimdhënies së mësimbesimit fetar	**2**	**60**	**Profesor specialistë në Metodikën e mësimdhënies së mësimbesimit fetar**

Lëndët obligative	S	ECTS	Lëndët obligative	S	ECTS
Didaktika dhe Metodika e mësimdhënies së mësimbesimit fetar	I	7	Etika e religjionit	II	5
Proekt hulumtues	I	6	Tregime nga Kurani	II	5
Demokracia dhe të drejtat e njeriut	I	7	Punimi i specializimit	II	15
Lëndët zgjedhore	**S**	**ECTS**	**Lëndët zgjedhore**	**S**	**ECTS**
Komunikimi i thirjes Islame në kohën bashkëkohore	I,II	5	Teknologjia e procesit të mësimdhënies	I,II	5
Historia e kulturës Islame dhe civilizimi	I,II	5	Teoria, gjuha, stili dhe përkthimi i Kuranit	I,II	5
Historia moderne e botës muslimane dhe organizatave islame	I,II	5	Sisteme Komperative i religjioneve	I,II	5
Dialogu ndërfetar	I,II	5	Psikologjia zhvillimore	I,II	5
Religjioni dhe shoqëria	I,II	5			

Aplikimi në ciklin e parë | **Afati parë në Gusht** | **Afati dytë në Shtator**

I. SI BËHET APLIKIMI:

- Fillimisht plotëso formularin për aplikim online në www.fshi.edu.mk;
- Dorëzo dokumentet në administratën e fakultetit, brenda datave për aplikim;
- Bëje pagesën e caktuar për aplikim dhe dorëzoje në administratë së bashku me dokumentacionin e kërkuar në konkurs.

II. KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM:

- Të drejtë regjistrimi për studime deridiplomike kanë kandidatët që kanë të kryer ***shkollën e mesme katërvjeçare, respektivisht*** të gjithë ata që kanë mbaruar Medresenë "Isa Beu" në Shkup dhe paralelet e saja.
- Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt dhe studentë me korrespodencë, me bashkëfinancim të studimeve.
- Në studime deridiplomike të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer arsimim të lartë apo sipëror, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta

  Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në **10%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në Konkurs.
- Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm. Ngjashmërinë e vërteton dhe e shpall Fakulteti. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me bashkëfinancim të studimeve, varësisht a regjistrohen si student të rregull ose me korrespodencë
- Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë. Kandidatët mund të fitojnë më së shumti 100 pikë, edhe atë: suksesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me 60 pikë, ndërsa suksesi i arritur nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve merr pjesë me 40 pikë.

a1. Llogaritja e pikëve nga suksesi i arsimit të mesëm:

Llogaritja e pikëve vetëm nga suksesi i arritur në arsimin e mesëm, bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, suksesi mestar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **60 pikë**.

a2. Llogaritja e pikëve nga kontrollimi i talentit të kandidatit:

Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve bëhet me fitimin nga **0** deri në **40 pikë**. Kontrollimi ka karakter eliminues. Nuk rangohen kandidatët të cilët kanë fituar më së paku **10 pikë**.

III. Seleksionimi i kandidatëve

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Dekanati formon Komision Qendror të Konkursit.
2. Për llogaritjen e pikëve nga suksesi i arritur nga arsimi i mesëm dhe nga suksesi i arritur nga kontrollimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve, Dekanati formon Komision për kontrollin e njohurive dhe diturive.
3. Komisioni Qendror i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit, jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.
4. Rangimin e kandidatëve e kryen Komisioni Qendror i Konkursit i Fakultetit.
5. Komisioni Qendror i Konkursit, në tabelat e shpalljeve të Fakultetit e shpall rangimin sipas poenëve nga suksesi i arsimit të mesëm (shumën e fituar), dhe nga rezultatet e kontrollimit të njohurive dhe talentit.
6. Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni Qendror i Konkursit, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.
7. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet Komisionit Qendror të Konkursit. Aktvendimi i Komisioni Qendror është përfundimtar. Vendimet për kundërshtimet shpallen në Fakultet.

8. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni Qendror i Konkursit shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (Rang lista përfundimtare), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve
9. Nëse pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, atëherë regjistri i studentëve bëhet në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.
10. Nëse në afatin e parë regjistrues, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), Fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë Fakulteti kandidatët e tillë i rangon sipas kritereve plotësuese: çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.
11. Studentët e rregullt regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, në shumë prej 100 euro për një semestër, respektivisht 200 euro për një vit akademik, me kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV. Pagesa e kompensimit mundë të kryhet në dy këste të barabarta.
11. Kompensimi nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë gjatë periudhës së përgjithshme të studimeve.
12. Dekanati sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

IV. Regjistrimi i studentëve me korrespodencë

1. Student me korrespodencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt.
2. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijim të rregullt të mësimit më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë.

3. Studentët me korrespodencë regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit. Studentët me korrespodencë regjistrohen me vetëfinancim të studimeve.
4. Studentët me korrespodencë regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, në shumë prej **200** euro për një semestër, respektivisht **400** euro për një vit akademik, me kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Populllore të RMV. Pagesa e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta.
5. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespodencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.
6. Studentët me korrespodencë gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

V. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit

a) Shtetasit e huaj

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs.
2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për studim **kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive.**
3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë dëftesë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, certifikatë për gjendjen shëndetësore dhe vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme për **lejeqëndrim** në RMV. Shtetasit e huaj, **diplomën** për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe **dëftesat** për të gjitha klasat, duhet t'i kenë të **nostrifikuara në RMV**.

4. Pagesa e studimeve për studentët e rregullt, shtetasit e huaj për vitin shkollor 2021/22 është në vlerë prej **100 euro për një semestër** respektivisht **200** për një vit akademik, kurse studentët me korrespondencë paguajnë **200 euro për një semestër** respektivisht **400 euro** për një vit akademik.

5. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë Veriore.

6. Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim. Shtetasit e huaj pranohen në Listë të veçantë dhe numri i tyre nuk tejkalon 10%.

b)Mërgimtarët dhe shtetasit e RMV-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë tanë dhe kandidatët shtetas të RMV, që **arsimin e mesëm të plotë** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me bashkëfinancim të studimeve.

2.Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1 **kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive.**

3. Kompensimet për studime të kësaj kategorie të studentëve vlejnë rregullat për pagesë **si për kandidatët nga kreu -V-**.

4.Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë **diplomë, dëftesa të nostrifikuara** për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

5. Kandidatët shtetas të RMV-së, që **një pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen me kushte dhe kritere të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë Veriore, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit.

6. Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës së rregullt ose me korrespodencë. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti **10%**.

VII. Dokumentet për paraqitje dhe regjistrim

Gjatë **paraqitjes** për regjistrim në fakultetet, kandidatët i dorëzojnë këto dokumente:

- formulari i plotësuar nga aplikimi online: www.fshi.edu.mk;
- fletëparaqitje për regjistrim;
- dëftesa origjinale dhe kopje për të gjitha klasat;
- dëftesë për kryerjen e shkollës së mesme origjinal dhe kopje;
- certifikatë nga libri amzë i të lindurve origjinal dhe kopje;
- referencë nga muftinia përkatëse;
- vërtetim për nënshtetësi të RMV (Certifikat ose Vendim);
- vërtetim për pagesat e:

  1000 denarë në emër të taksave administrative;

  600 denarë mjete plotësuese për secilën lëndë të theksuar në Listën shtesë-**1**, të Programit studimor përkatës, në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive.

Gjatë **regjistrimit**, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit).

- Tri fotografi (*një* fotografi 6 x 9 dhe *dy* 4 x 5 c.m.)
- Vërtetim për pagesën e mjeteve:

  500 dinarë, në emër të dhënies së Indexit.

  400 dinarë pagesa për fletoret e provimit.

  300 dinarë pagesa për Revistën mujore ”Hëna e Re”.

  100 dinarë në emër të Kuvendit studentorë në FSHI.

pagesë e mjeteve për semestrin e parë, varësisht nga statusi i studimit të bëhet në xhiro-llogarinë e Fakultetit: HALKBANK AD SHKUP 270070852730133.

Vërejtje: Dokumentacioni origjinal i cili dorëzohet gjatë aplikimit i njëjti në fazën e regjistrimit u kthehet kandidatëve por pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar.

Lista 1 - Lloji dhe përmbajtja e testimit/seleksionimit plotësues të kandidatëve

Provimi pranues do të mbahet vetëm nga lënda e Kur’ani Kerimit dhe atë:

A. Lexim nga Kur’ani Kerimi,

B. Texhvid dhe

C. Pjesë të nxërë përmendësh nga Kur’ani Kerimi.

Për informata më të hollësishme vizitoni faqen zyrtare të Fakultetit http://www.fshi.edu.mk).

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

Data ___/___/202__

FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME - SHKUP

Факултет за Исламски Науки - Скопје

Faculty of Islamic Science - Skopje

İslâmî Bilimler Fakültesi – Üsküp

Fillo Studio Hulumto Islamin